

STATUT I SHOQERISE TREGTARE

“ARIS SHOES” shpk

KREU 1

DISPOZITA TE PEGJITHSHME

NENI 1

THEMELIMI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ARIS SHOES” shpk themelohet me date. 25.07.2017 sipas Akt Themelimit qe I bashkengjitet ketij Statuti.

Kjo shoqeri themelohet nga ortaku z. Alban Beqiraj i datelindjes 15/03/1984 lindur dhe banue ne Vlore me ID 140315106M

Otaku i kesaj shoqerie deklaroi se Shoqeria do te rregullohet sipas Ligjit 9901 i dt. 14/04/2000 “per shoqerite Tregtare”

Kjo shoderi eshte person Juridik dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe akteve te saj themeluese si ky statut dhe akteve te tjera themeluese, si dhe Aktit te themelimit qe i bashkohet dhe permban nje pjese te pandare te tij.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ARIS SHOES” shpk do te jete:

Lagjia 24 Maji, rr. Zahir Pajaziti, godine 2-kateshe (ish Fabrika e Makaronave), prane stacioni te trenit Vlore. Pasuria nr. 4/107-ND2

Aktiviteti i shoqerise so te shtrihet ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë ketij territori.

Shoqeria ka te drejte te cete filiale, agjensi, dege ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te jete:

Aktivitet ne fushen e Perpunimit Aktiv. Aktivitet ne fushen e prodhimit: prerje, qepje dhe vendosje aksesoresh te faqeve te kepuceve, sandale, cizme, ngritje linje prodhimi per prodhimin e ketyre produkteve gjysem te gatshme e te aksesoreve te tyre.

Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice te tyre. Aktivitete ne fushen e tregtise. Aktivitet ne fushen e marketingut. Aktivitet ne fushen e sherbimeve si hapje agjensi udhetimesh, transporti etj. Aktivitet ne fushen e hoteleri-turizem.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqersie do te jete per nja afat te pacaktuar

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 lek, kontribut i ortakut te vetem te shoqerise i ndare ne 1 kuote. 100% kapital i ortakut te vetem

NENI 6

TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Kapitali themeltar apo pjese te tij jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie apo personave te trete. Ky transferim i pjeseve kryhet gjithmone me nje akt noterial.

NENI 7

ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete z. Alban Beqiraj me nje afat 5 vjeçar.

NENI 8

MENYRA E DREJTIMIT

Shoqeria do te drejtohet me vendim te ortakeve, me akt emerimi, nga nj administrator apo keshill administratoresh, sipas nje numri te caktuar nga ortaket.

NENI 9

PERFAQESIMI

Administrator i vetem perfaqeson shoqerine

Ne rastet e emerimite te nje keshilli administrativ, administratoret e deleguar jane te legjitimuar te perfaqesojne shoqerine ne kufijte e ceshtjeve qe u jane deleguar. Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme me te trete. Te paraqitet prane llogarive bankare per te kryer veprime meto ne emer te shoqerise ose te caktoje dike tjeter per te kryer veprime bankare me ane te nje akti noterial.

NENI 10

VENDIMET E ORTAKVE-KOMPETENCAT

Ortaket vendosin mbi ceshtjet qe u perkasin me ligj si dhe ceshtjet qe vihen per miratim nga administratori/administratoret

I perket Ortakeve vendimi ne lidhje me emerimin e likujdatoreve dhe ne lidhje me kriteret e zhvillimit te likujdimit, trasferimi i qendres se shoqerise, rritjen dhe zvogelimin e kapitalit, miratim bilanci, ndryshimet ne statut etj.

NENI 11

E DREJTA E VOTES

Kane te drejte vote ortaket e shkruar ne librin e ortakve. Ne cdo rast vota i takon cdo ortaku ne mase perpjestimore me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e shoqerise.

NENI 12

KONSULTIMI ME SHKRIM DHE MIRATIMI I SHPREHUR ME SHKRIM

Me perjashtim te cka parashikohet ne piken e pare te nenit 13 te meposhtem vendimet e ortakeve mund te merren me ane te konsultimit me shkrim dmth mbi bazen e miratimit te shprehur me shkrim. Vendimet marrin daten e deklarates se fundit ne afatin e percaktuar qe me pare. Vendimet e ortakeve te marra ne zbatim te ketij neni duhet te transkriptohen pa hezitim ne librin e ortakeve .

NENI 13

1. Asambleja mund te thirret nga administratori edhe jashte qendres se shoqerise me kusht qe te jete ne shqiperi dhe te jete kuorumi I kerkuar per vendimmarrje. Ne rast te pamundesise te administratoreve, asambleja mund te thirret nga nje ortak qe zoteron te pakten 5% te kuotave te shoqerise.
2. Asambleja thirret me ljmerim te shkruar i cili duhet te merret te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen me leter rekomande, fax apo mesazh te postes elektronike, e cila u cohet ne adresen e shtepise qe rezulton nga librat e shoqerise atyre qe e kane kete te drejte, ne njoftimin e thirrjes dita, vendi, ora e mbledhjes dhe ceshtjet per tu trajtuar. Ne njoftimin e thirrjes mund te caktohet edhe nje date tjeter per nje thirrje te dyte ne rast se ne mbledhjen e parashikuar ne thirrjen e pare nuk rezulton ligjerisht e formuar, sidoqofte edhe ne thirrjen e dyte vlejne te njejtat shumica te arashikuara ne ne thirrjen e pare.
3. Edhe ne mungese te thirrjes formale asambleja konsiderohet rregullisht e mbledhur kur ne temarrin pjese ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise dhe administratoret jane te pranishem e te informuar dhe asnje nuk i kundervihet trajtimit te argumentit. Neqoftese administratoret nuk masrrin pjese rregullisht ne asamble, do te duhet te japin deklarate te posacme me shkrim e cila ruhet ne aktet e shoqerise, ku deklarojne se jane informuar mbi mbledhjen dhe nuk i kundervihen argumenteve ne rendin e dites.

NENI 14

PROCEVERBALI I ASAMBLESE

Vendimet e asamblese duhet te rezultojne nga procesverbali i firmosur prej te gjithë ortakeve dhe per rastet e parashikuara nga ligji edhe i vertetuar nga Noteri. Proceverbali duhet te tregojë daten e mbledhjes, identitetet e pjesemarrësve, kapitalin e perfaqesuar nga secili, menytrat e votimit, rezultatet e votimit dhe duhet te lejoje qofte edhe me bashkelidhje identitetetin e

ortakeve pro, abstenues apo kundra. Proceverbali duhet te transkriptohej pa hezitim ne librin e vendimeve te ortakeve.

NENI 15

KUORUMET, PERBERJA DHE VENDIMARRJA

Asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoteriojne me shume se 30% te kuotave . ne rastet kur asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoteriojne me shume se gjysma e kuotave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo mjete elektronike, sic parashikohet pika 3 e nenit 88 te ligjit 9901 date 14.04.2008. Per ceshtje te tilla si: Ndryshim Statuti, rritje e zvogelim kapitali, vendime per te kryer operacione per blerjen e kuotave ne shoqeri te tjera, vendime lidhur me shkrirjen e parakohshme te shoqerise dhe me revokimi e zevendesim te likujdatoreve si dhe kriteret e kryerjes se likujdimit, vendimet lidhur me transaksionet , operacionet bankare, blerje apo shitje te pasurive te paluajteshme eshte i nevojshem miratimi i te pakten 75% te ortakeve pjesemarrres ne asamble.

NENI 16

VITI EKONOMIK, BILANCI, FITIMET

Viti ekonomik i shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Bilanci i shoqerise paraqitet nga ortaket brenda 120 ditesh nga mbyllja e vitit ekonomik ose, nese shoqeria duhet te beje redaktimin e bilancit te te konsoliduar apo kur shfaqen nevoja te vecanta ne lidhje me strukturen dhe objektin e shoqerise, brenda 180 ditesh nga mbyllja e vitit ekonomik. Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci do te ndahen midis ortakeve ne raport em pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e shoqerise, me perjashtim te ndonje vendimi te ndryshem te ortakeve.

NENI 17

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Ne cdo moment dhe per cfaredo shkak shoqeria mund te shperndahet me vendim unanim te asamblese se ortakeve, normat per likujdimin dhe per emerimin e likujdatorit apo likujdatoreve do te vendosen prej asamblese se ortakeve sipas dispozitave te legjislacionit ne fuqi.

SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

NENI 18 REGJISTRIMI I SHPËRBËRJES

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim

NENI 19 DISPOZITA PER FUNDIMTARE

Persa nuk parashikohet në këtë statut i referohemi dispozitave ligjore në fuqi.

Ky statut nënshkruhet sot me 26/07/2017 nga ortaket:

Ortaku i vetëm

Alban BEQIRAJ

